

VENDIM
Nr.837, datë 3.12.2014

PËR NJOHJEN E GJUHËS SË SHENJAVE NË REPUBLIKËN SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 18 e 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 4, 5, 9, 13, 21, 24 e 30, të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ratifikuar me ligjin nr. 108/2012, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është autoriteti përgjegjës për koordinimin e procesit të zbatimit të detyrimeve si dhe të vlerësimit e të bashkërendimit të legjislacionit, politikave, programeve për gjuhën e shenjave në Shqipëri dhe çështjeve që lidhen me respektimin e të drejtave të personave që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të hartojë platformën me masat për veprim, në zbatim të këtij vendimi, ku të përcaktohen detyrimet për institucionet që duhet të ofrojnë shërbimin e gjuhës së shenjave.

3. Njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë për njerëzit që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama